



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.178 dt.29.09.2000

MBI

**NDRYSHIMIN E PAGAVE PER PUNONJESIT E NDERMARRJEVE
BUXHETORE NE VARESI TE BASHKISE (NPA-1 DHE RERE SHTUFI)**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të radhës dt.29.09.2000, pasi shqyrtoi dhe diskutoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Industrisë mbi “Ndryshimin e pagave për punonjësit e ndërmarrjeve buxhetore në varësi të Bashkisë (NPA-1 dhe fabrika e “Rërë Shtufit”, mbështetur në VKM Nr.378, dt.14.07.2000 “Për disa ndryshime “ në vendimin Nr.393, dt.03.09.1992, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, mbështetur në kompetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, neni.7, në vendimin Nr.204, dt.26.03.1998, “Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal”,

V E N D O S I

1. Miratimin për rritjen e pagave të punonjësve në masën 10% për ndërmarrjet NPA-1 dhe “Rërë Shtufi”, konkretisht me ndryshimet si më poshtë:

Drejtori	paga nga	9504 lekë	bëhet	10454,4 lekë/muaj
Financieri	paga nga	7260 lekë	bëhet	7986 lekë/muaj
Roja	paga nga	6600 lekë	bëhet	7260 lekë/muaj
Komisioni bankar				450 lekë/muaj

2. Vendimi i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2000.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Financës dhe dy ndërmarrjet e NPA-1 dhe “Rërë Shtufit”.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI